



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1280/Prot  
3

Tiranë, më 25/01/2016

**Lënda:** Për ankesën për mos njoftim dhe konsultim publik të projektaktit “Për Amnistinë”.

**Drejtuar:** QENDRËS RES PUBLIKA

**Për dijeni:** MINISTRISË SË DREJTESISË

Tiranë

Pranë Zyrës së Komisionerit nga ana juaj është depozituar ankesë për mosrespektimin e procedurës për njoftim dhe konsultim publik të projektaktit “Për Amnistinë”.

Nga shqyrtimi i bërë ankesës, konstatohet se keni depozituar kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë me objekt, “Përfshirjen në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në lidhje me projektaktin “Për Amnistinë”.

Në përgjigje të kërkesës, Ministria e Drejtësisë në rrugë elektronike në datë 18.12.2015, ka bërë me dije se “Projektligji për amnistinë është miratuar nga Këshilli i Ministrave në datë 11.12.2015 dhe se projektakti po shqyrtohet në komisionet parlamentare, për pasojë ju mund t’i drejtoheni Kuvendit për të qenë pjesë e konsultimit publik”.

Rezulton se ankesa është depozituar në përputhje me parashikimin e bërë në nenin 21, pika 1/b e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, për shkak se projektakti është njoftuar i miratuar dhe si e tillë ankuesi legjitimohet në paraqitjen e saj në afat.

Gjithashtu, rezulton se ankuesi legjitimohet edhe në ngritjen e objektit të kësaj ankese në përputhje me pikën 1/b të nenit 8 të ligjit 146/2014, në të cilën thuhet shprehimisht se, “...palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik janë shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit...”. Qendra “Res Publika” është një organizatë që ofron ndihmë ligjore në interes publik, prandaj në kuptim të ligjit 146/2014 ka të drejtë të marrë pjesë në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

Në përputhje me pikën 3 të nenit 21 të këtij ligji në të cilin citohet se “...me marrjen e një ankese, Komisioneri i kërkon ankuesit dhe organit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve”. Komisioneri ka kërkuar organit publik, Ministrisë së Drejtësisë paraqitjen e parashtrimeve brenda këtij afati.

Ministria e Drejtësisë ka paraqitur parashtrimet e kërkuara brenda afatit ligjor duke dhënë argumente përkatëse. Pas njohjes me to, konstatohet se ende nuk është përmbushur një kërkesë e rëndësishme e ligjit, krijimi dhe administrimi i regjistrit elektronik si një mënyrë e mirë për të bërë publike p/aktet e autoriteteve publike përpara miratimit të tyre.

Kjo kërkesë vjen si rezultat i parashikimit të bërë shprehimisht në nenin 6 pikat 1/a) dhe 1/c) të këtij ligji, sipas të cilit *“Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë:*

*a) publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve;*

*c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar”.*

Megjithatë, kjo nuk pengon publikimin e p/aktit, pasi ligji njih edhe forma e mënyra të tjera të parashikuara shprehimisht në nenin 11 sipas të cilit njoftimi i një p/akti, bëhet i mundur me *“...postë elektronike, me lajmërim publik i cili afishohet në ambjentet e organit iniciues, me një lajmërim në mediat audiovizive, me botimin në gazeta lokale, ose në dy gazetatat e lexuara në nivel kombëtar...”*

Ligji nr.146/2014, parashikon shumë mundësi për të tërhequr mendime dhe sugjerime të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e tyre, nga momenti i publikimit deri në miratimin përfundimtar.

Në këtë rast, projektligji “Për Amnistinë” përmbush një qëllim të caktuar, synon zbatimin e tij në një kohë të caktuar dhe për rrjedhojë rezultoi të ketë ndjekur një procedurë të përsheptuar në draftim dhe miratim, referuar parashtrimeve të Ministrisë së Drejtësisë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nuk mund të shërbejnë për të mos kryer procesin e njoftimit dhe konsultimit publik nga organi publik.

Gjithashtu konstaton se megjithëse ka shkelje të dispozitave të këtij ligji, nuk mund të propozojë organit publik përgjegjës marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës, sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi (neni 21/4 i ligjit 146/2014).

Duke ju falënderuar për kontributin tuaj.

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**